



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 268, datë 03.12.2019

PËR
RISHPËRNDARJEN E FONDEVE BUXHETORE, NË SISTEMIN GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 61 pika 1 shkronja “dh”, 95 dhe 96 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 343 datë 02.5.2019, “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve dhe të fondeve buxhetore për institucionet e Sistemit të Drejtësisë, për vitin 2019”, në Udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor, si më poshtë:
 - a) Rialokimim e fondeve në programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim” 1110, pakësuar nga shpenzimet operative, shtuar në shpenzime paga, për vlerën 3 500 mijë lekë, sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
 - b) Rialokimin e fondeve në programin “Buxheti gjyqësor” 3310, pakësuar nga shpenzime paga (fonde të lira), shtuar në shpenzime për paga, sipas tabelës nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi, në favor të:
 - i) Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane për vlerën 21 000 mijë lekë;
 - ii) Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për një vlerë 3 600 mijë lekë;
 - iii) Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për një vlerë 300 mijë lekë;
 - iv) Gjykatës Apelit Durrës, për një vlerë 800 mijë lekë.
2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR